



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA Durrës**  
**KËSHILLI BASHKIAK**



**VENDIM**

Nr. 166, datë 03.11.2023

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT ARTISTIK PRANË  
QENDRËS KULTURORE “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023” dhe sipas Relacionit të Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ngritjes dhe funksionimit të Bordit Artistik pranë Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu” Durrës, me përbërjen si më poshtë:

- |            |          |                            |
|------------|----------|----------------------------|
| • Miltiadh | Kutali   | Regjisor, Petagog          |
| • Ali      | Bega     | Aktor                      |
| • Orges    | Mema     | Dirigjent                  |
| • Oltsen   | Gripshi  | Kritik Arti                |
| • Elio     | Bajramaj | Drejtor (Q.K. “A. Moisiu”) |

1.1 Anëtarët e bordit kanë mandat 4-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

2. Miratimin e masës së shpërblimit për çdo anëtar të Bordit Artistik pranë Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu” në shumën prej 4500 (katërmijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
3. Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Artistik do të përballohet nga shpenzimet operative (Art.602) të Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”, Durrës.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 607, datë 31.05.2019 “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit Artistik pranë Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu” Durrës, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Drejtorja e Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Kulturore “Aleksandër Moisiu”, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 06.11.2023**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 709 / Prot.  
6

Durrës, më 13 / 11 / 2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.166 datë 03.11.2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit artistik pranë qendrës kulturore “Aleksandër Moisiu”, Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

